



REPUBLIKA E KOSOVES
REPUBLIC OF KOSOVA
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E DECANIT
MUNICIPALITY OF DECAN
OPSTINA DECAN



Drejtoria për Gjeodezi dhe Kadaster
12- Zyrtarisht /2026
Decan.26.01.2026

Për: Kryetarin e Komunës së Decanit
Z. Bashkim Ramosaj

Përmes: Drejtorit të Drejtorisë Z. Agron Muslija

Nga : UD Shefi i Drejtorisë Z. Muhamet Avdiqaj

Lënda: Plani i Punës për periudhën 04 Janar 2026 – Dhjetor 2026,
i Drejtorisë për Gjeodezi dhe Kadaster në Komunën e Decanit



Së bashku me këtë shkresë do gjeni edhe Plani i Punës për periudhën 04 Janar 2026 – Dhjetor 2026, i Drejtorisë për Gjeodezi dhe Kadaster në Komunën e Decanit

PLAN P UNE

Për periudhën Janar — Dhjetor 2026 i Drejtorisë për Gjeodezi dhe Kadastër ne Dëgan

1. Shefi i Shërbimit njëkohësisht edhe zyrtari për RDPP se bashku me referentën e ndryshimeve kadastrale

Megjenëse Drejtoria jone Kryesisht punon ne baze te kërkesave te palëve , nuk kemi mundësi reale qe te caktojmë volumin e punëve për vitin 2026, por ne duke u bazuar ne statistikat qe i mbajnë për çdo vit mendojmë se ne këtë trend te rritjes se volumit te punëve krahasuar me vitet paraprake.

Ne vazhdim ne baze te punëve te kryera ne vitet e kaluar dhe bazuar ne trendin e rritjes se kërkesave te palëve po japim një pasqyre e cila do na shërbejë si orientim i synimeve te kryerjes se punëve brenda vitit planifikues dhe atë për secilin vend pune.

Zyrtari për RDPP — njëkohësisht Shefi i Drejtorisë për Kadastër dhe Zyrtari i Ndërrimeve kadastrale planifikojnë qe ne këtë vit te shqyrtoi përafërsisht 800-1200 kërkesa te palëve te cilat kane te bëjnë me ndërrimin e pronareve dhe fuqjen e te dhënave te reja ne sistemin e SIKTK-es.

Krahas këtyre punëve Zyrtari për RDPP i cili i kryen edhe detyrat e shefit te shërbimit i dhe se bashku me Referentin për ndryshime kadastrale kryejnë edhe pune tjera me urdhër te drejtorit dhe sipas nevojës .

2. Zyrtarët e mirëmbajtjes së Kadastrit

Ne këtë sektor punojnë dy zyrtar për mirëmbajtjen e Kadastrit dhe një Gjeometer

Këta zyrtar gjate periudhës 01.01.2026 deri 31.12.2026, mendojmë se do kryejnë afro 550 raste tereni sipas kërkesës se palëve për te cilat do bëjnë azhurnimin adekuat neper librat kadastral dhe me pas për këto lëndë nxjerrin vendime adekuate .

Punët ne teren do i kryejnë Kompanitë dhe Gjeodetët e Licencuar për shkak se me ligje kjo punë iu është lënë vetëm Gjeodetëve dhe Kompanive Gjeodete dhe Gjeodetëve të Licencuara.

Gjithashtu. Këta zyrtar mendojmë se do kryejnë me tepër se 60 raste të lëshuajtjes së Historiateve si dhe do dalin ne teren sipas nevojave dhe kërkesave zyrtare të Komunës.

Te njëjtit do kryejnë edhe detyra tjera sipas nevojave te cilat paraqiten në këtë shërbim siç janë lëshuajta e kopjeve të planit konsultat me pale dhe pune tjera ne zyre.

3. Referenti për pranimin e palëve i cili punon me punë shtesë

Gjate kësaj periudhe , referenti për pranimin e palëve mendojmë se do pranojë përafërsisht 5000 kërkesa te cilat kryesisht kane te bëjnë me dhënie e certifikatave te pronës se paluajtshme, kopjeve te planit dhe vërtetimeve me te cilat vërtetohet se a ka apo nuk ka pala pasuri te paluajtshme, ne territorin e Komunës etj..

I njëjti zyrtar i procedon te gjitha këto kërkesa dhe për secilin kërkesë palët pajisen me dokumente përkatëse ne afatin brenda ditës se paraqitjes se kërkesës.

Ky plan i punës nuk parashihet 100% punët qe do kryhen gjate vitit 2026 por siç u tha edhe me lartë është plan orientues i cili është përpiluar duke u bazuar ne statistikat e punëve te kryera nga vitet paraprake i cili shihet se për secilin vit ka tendenca te rritjes volumit te punës.

Raportin e hartoi :

UD Shefi i kësaj Drejtorie

Muhamet Avdiqaj



Planin e Aprovoi :

Drejtori

Agromi Mustifaj

